

HELIUS SYSTEMS SH.P.K
Pasqyrat Financiare te mbyllura ne daten
31 Dhjetor 2024
(se bashku me raportin e auditimit)

A handwritten signature in black ink, consisting of a stylized, cursive letter 'G' or similar character.

Permbajtja

Raporti i audituesit te pavarur

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e performances financiare	2
Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (Metoda indirekte)	3
Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto	4

Shenime per Pasqyrat Financiare

1 Hyrje	5
2 Baza e pergatitjes	6
3 Permbledhje e politikave kontabel te rendesishme	6-13
4 Menaxhimi i riskut financiar	14-15
5 Aktivet Afatgjata Materiale	16
6 Kerkesa te Arketueshme	17
7 Kerkesa te tjera te arketueshme	18
8 Aktivet monetare	18
9 Kapitali	19
10 Rezervat	19
11 Detyrime afatgjata per qera financiare dhe grante	20
12 Furnitore	21-22
13 Te tjera te pagueshme	22
14 Tatim fitimi	23
15 Shoqeri te lidhura	24
16 Te ardhurat dhe shpenzimet	25-26



HELIUS SYSTEMS Sh.p.k.**Pasqyra e pozicionit financiar e mbyllur me 31 Dhjetor 2024**

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET		
Aktivitet afatgjata		
Aktivitet afatgjata materiale	13,348,341	9,755,488
Aktivitet afatgjata jomateriale	155,581	207,441
E drejta e perdorimit te asetëve	8,833,491	3,420,457
Investimet ne pjesemarrje	450,000	450,000
	<u>22,787,413</u>	<u>13,833,386</u>
Aktivitet afatshkurtra		
Inventari	-	-
Llogari te arketueshme tregtare	186,372,504	98,023,731
Llogari te tjera te arkerueshme	17,523,849	4,307,571
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	47,153,271	87,389,893
	<u>251,049,623</u>	<u>189,721,195</u>
Totali i aktiveve	<u>273,837,036</u>	<u>203,554,581</u>
KAPITALI		
Kapitali i nenshkruar	1,000,000	1,000,000
Humbje/fitime të mbartura	128,420,985	74,129,685
Fitim/Humbje e vitit	23,819,729	104,436,298
	<u>153,240,715</u>	<u>179,565,983</u>
DETYRIMET		
Detyrimet afatgjata		
Huamarrje nga palet e lidhura		
Detyrim per qirane financiare afatgjate	6,093,691	3,468,898
Grante dhe te ardhura te shtyra	1,018,638	1,018,638
	<u>7,112,329</u>	<u>4,487,536</u>
Detyrimet afatshkurtra		
Huamarrje afatshkurter		
Detyrimi per qirane financiare afatshkurter	3,130,833	-
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	20,366,225	6,612,474
Llogari të pagueshme nga palet e lidhura	14,437,641	597,621
Llogari te tjera te pagueshme	75,549,293	12,290,968
Totali i detyrimeve afatshkurtra	<u>113,483,992</u>	<u>19,501,063</u>
Detyrime totale	<u>120,596,321</u>	<u>23,988,598</u>
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	<u>273,837,036</u>	<u>203,554,581</u>

*Bilanci duhet te lexohet duke iu referuar shenimeve ne faqet 5 deri 26 dhe si pjese perberese e pasqyrave financiare.



HELIUS SYSTEMS Sh.p.k.**Pasqyra e performancës financiare më 31 Dhjetor 2024**

	<u>01/01/2024- 31/12/2024</u>	<u>01/01/2023- 31/12/2023</u>
Shitjet neto	286,290,662	315,532,078
Materialet e konsumuara		
Fitimi bruto	286,290,662	315,532,078
Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit	2,206,000	3,380,245
Shpenzime te tjera	(141,579,478)	(89,742,464)
Kosto e punes	(108,266,918)	(101,724,117)
Amortizime dhe zhvleresimit	(6,072,198)	(6,227,730)
Fitime (humbjet) nga kursi i kembimit	(7,015,776)	(10,773,391)
Totali i shpenzimeve	(260,728,371)	(205,087,456)
 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore	 25,562,292	 110,444,622
Shpenzime finaciare	(233,044)	(357,108)
Te ardhura financiare		4,951
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	(233,044)	(352,157)
 Fitim (humbje) para tatimit	 25,329,248	 110,092,465
Tatim i shtyre		
Shpenzimet e tatim fitimit	(1,509,519)	(5,656,168)
 Fitimi (humbje) neto e vitit financiar	 23,819,729	 104,436,298

*Pasqyra e fitim/humbjeve duhet te lexohet duke iu referuar shenimeve ne faqet 5 deri 26 dhe si pjese e pasqyrave financiare.



Pasqyra e Fluksit te mjeteve monetare me 31 Dhjetor 2024

Metoda Indirekte	01/01/2024- 31/12/2024	01/01/2023- 31/12/2023
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	25,329,248	110,092,465
Rregullime per shpenzimet jo-monetare:	(1,509,519)	(5,656,168)
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jo-monetar (diferenca shpenzim - pagese gjate periudhes)		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,072,198	6,227,730
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme		
Ulje ne vleren neto te realizueshme per inventaret		
Provizione per shpenzime		
Shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te konstatuara		
Te tjera (pershkruaj)		
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese		
(Fitim)/humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
(Fitim)/humbja nga investimet ne pjesmarre		
Interesa te fituara		
Te tjera (pershkruaj)		
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	(101,565,050)	(1,745,311)
Renie/(Rritje) ne inventar	-	-
Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme	13,753,752	(9,537,960)
Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit		
Te tjera (pershkruaj)	80,229,178	(7,036,698)
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	22,309,807	92,344,059
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale		
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Para te perdorura per blerjen e filjaleve (netuar me shumen e mjeteve monetare pjese e aktiveve neto te blera)		
Para te arketuara nga shitja e filjaleve (netuar me shumen e mjeteve monetare pjese e aktiveve neto te shitura)		
Pagesa per blerjen e investimeve te tjera	(15,026,226)	(1,221,211)
Arketime nga shitja e investimeve te tjera		
Dividente te arketuar	(50,144,997)	(52,775,000)
Interesa te arketuara		
Te tjera (pershkruaj)		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(65,171,223)	(53,996,211)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar		
Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura si kolateral		
Hua te arketuara		
Pagesa e kostove te transaksionit qe lidhet me kredite dhe huate		
Riblerje e aksioneve te veta		
Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral		
Pagesa e huave	-	(2,945,251)
Pagese e detyrimeve te qirase financiare		
Interes i paguar		
Dividende te paguar pronareve te njesive ekonomike meme		
Dividende te paguar interesave jokontrollues		
Te tjera (pershkruaj)	2,624,793	(3,314,921)
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	2,624,793	(6,260,172)
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	(40,236,623)	32,087,675
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	87,389,893	55,302,218
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	47,153,271	87,389,893

*Pasqyra e fluksit te parase duhet te lexohet duke iu referuar shenimeve ne faqet 5 deri 26 dhe si pjese e pasqyrave financiare.

HELIUS SYSTEMS Sh.p.k.

Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto me 31 Dhjetor 2024

	Kapitali aksionar	Rezerve ligjore	Totali i rezervave	Fitime te pashperndara	Totali
Gjendje, 1 Janar 2024	1,000,000		-	128,420,985	129,420,985
Te ardhura neto per periudhen	-	-	-	23,819,729	23,819,729
Rritje e kapitalit te aksinerve	-	-	-	-	-
Dividente	-	-	-	-	-
Transferime tek rezervat	-	-	-	-	-
Te tjera	-	-	-	-	-
Shuma, 31 Dhjetor 2024	1,000,000	-	-	152,240,715	153,240,715
					-
					-
Gjendje, 1 Janar 2023	1,000,000			74,129,685	75,129,685
Te ardhura neto per periudhen	-	-	-	104,436,298	104,436,298
Rritje e kapitalit te aksinerve	-	-	-	-	-
Dividente	-	-	-	-	-
Transferime tek rezervat	-	-	-	-	-
Te tjera	-	-	-	-	-
Shuma, 31 Dhjetor 2023	1,000,000	-	-	178,565,983	179,565,983

*Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet duke iu referuar shenimeve ne faqet 5 deri 26 dhe si pjese e pasqyrave financiare.

Administrator:

Alkid Ademi

Alkid Ademi

Hartues:

Network Consulting Shpk

Network Consulting
Tirane - Albania

HELIUS SYSTEMS
MEMBER OF **asee**

1. Hyrje

Shoqeria Helius Systems Sh.p.k, eshte themeluar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 06/04/2009, me NUIS K91607030D.

Me 31 Dhjetor 2024, adresa e selise qendrore se kompanise eshte: Rruga Dritan Hoxha, Pallatet Komfort, kulla horizontale, kati 11, Tirane, Shqiperi.

Aktiviteti i shoqerise rregullohet me Ligjin nr. 9901 date 14.04.2016 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe nga statuti, si dhe nga legjislacioni shqiptar. Objekti i aktivitetit te shoqerise eshte: Krijimi, zhvillimi dhe implementimi i programeve software, ndertimi dhe integrimi i sistemeve teknologjike.

Kapitali i nenshkruar eshte regjistruar ne Leke shqiptare. Kapitali i shoqerise sipas aktit te themelimit ka vleren prej 1,000,000 leke.

Me 31 Dhjetor 2024, perqindja e aksioneve te mbajtura nga aksioneret eshte si me poshte:

<i>Emri i Aksionerit (Ortakut)</i>	<i>Numri i pergjithshem i kuotave</i>	<i>Perqindja e aksionit</i>	<i>Vlera e aksioneve</i>
Alkid Ademi	1.00	15.00%	150,000
Gjergji Mulla	1.00	15.00%	150,000
ASSECO SEE	1.00	70.00%	700,000
	3.00	1.00	1,000,000

Shoqeria Helius Systems Shpk ka si perfaqesues ligjor Z. Alkid Ademi.



2. Baza e Pergatitjes

(a) Parimi i perputhshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Financiare Nderkombetare te Raportimit (IFRS) sipas kerkesave te Ligjit Nr. 9228 date 29.04.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", pasi shoqeria eshte ne listen e shoqerive qe ne baze te te vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 783 date 22.11.2006 duhet te zbatoje SNRF-te, pasqyrat financiare me te fundit jane adoptuar ne pajtim me SNRF-te.

(b) Parimi i Matshmerise

Keto pasqyra financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike.

(c) Monedha funksionale

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne Leke.

Menyrat e vleresimit dhe gjykimit

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon qe menaxhimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime qe ndikojne ne zbatimin e politikave dhe ne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Vleresimet dhe supozimet qe i shoqerojne bazohen ne eksperiencen historike dhe faktore te tjere te cilet besohet se jane te arsyeshem ne rrethana te caktuara, rezultat i te cilave krijon bazen per gjykimet mbi vlerat e mbetura te te drejtave dhe detyrimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime. Vleresimet dhe supozimet e nenkuptuara jane rishikuar ne vazhdimesi. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen behet rishikimi dhe ne periudhat e ardhshme qe preken. Ne vecanti, informacioni mbi fusha te rendesishme te pasigurise se vleresimit dhe gjykimit kritik ne perputhje me politikat kontabel qe kane efektet me domethenese ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare jane pershkruar ne Shenimin 5.

Politikat kontable te dhena me poshte jane aplikuar ne vijimesi ne te gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare.

3. Permbledhje e politikave kontabel

(a) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane kembyer me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane kthyer me kursin e kembimit ne mbyllje te vitit. Diferencat nga kursi i kembimit jane te njohura ne pasqyren e fitimit ne Rezultate neto te kembimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe jane paraqitur me kosto historike jane kthyer me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe jane paraqitur me vlere tregu jane kthyer me kursin e dates kur eshte percaktuar vlere e tregut.

Normat e kembimit (Lek per monedhe te huaj) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 jane si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>
1 EUR	98.15	103.88
1 USD	94.26	93.94

(b) Instrumentat financiare

Instrumentat financiare jo – derivative perfshijne investimet ne letra me vlere te kapitalit, ne llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme, mjete monetare ne arke dhe ne banke, kredi dhe hua, llogari te pagueshme dhe te tjera te pagueshme. Me 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 nuk ka instrumenta financiare derivative. Asetet financiare jane matur fillimisht me vleren e duhur duke shtuar kostot e transaksionit qe jane te lidhur direkt me pervetesimin e tyre. Njohja ne vazhdim e aseteve financiare jo derivative pershkruhet si me poshte.

Mjetet monetare ne arke dhe ne banke perfshijne tepericat ne para. Overdraftet e ripagueshme me kerkese dhe qe formojne pjese integrale ne administrimin e mjeteve monetare te shoqerise, per qellime te pasqyres se fluksit te arkes. Regjistrimi kontabel per te ardhurat financiare dhe shpenzimet eshte sqaruar ne shenimin III.k.

Instrumentat financiare per shoqeri te lidhura.

Shoqeri te lidhura jane ato entitete ne te cilat ne kemi influence sinjifikative, por nuk kemi kontroll, mbi politikat financiare dhe operative.

Kapitali aksioner

Kapitali i aksionerve te Shoqerise njihet me vlere nominale.

Dividentet

Dividentet njihen si detyrim per periudhen ne te cilen ata deklarohen.

Te tjera

Aktive te tjera financiare maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

(c) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me koston e tyre historike shoqeria nuk ka bere rivleresuar aktivet afatgjata materiale

Kostot perfshine shpenzimet qe jane bere direkt te atribueshme per blerjen e aktivit. Kostot e aktivitet te ndertuara nga vete shoqeria , perfshin koston materiale dhe te fuqise puntore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet direkt me venien e aktivitet ne kushte pune, si dhe kostot e cmontimit dhe te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendedodhjen perkatese. Kosto e financimit ne lidhje me blerjen apo ndertimin e aktiveve specifike njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me te ndodhur.

Kur pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale kane jete te dobishme te ndryshme,ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponente kryesor) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e nje zeri te aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar te hyrat monetare nga shitja me vleren e mbartur te aktiveve materiale te trupezuara , dhe njihen neto brenda zerit " te ardhura te tjera " ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve . Kur aktivet e rivleresuara shiten, sasite e perfshira ne rezerven se rivleresimit transferohen ne fitimin e mbajtur, ndersa deficitet i rivleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimit te periudhes.

(ci)Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te aktiveve afatgjata materiale njihen ne vleren mbartur te nje zeri nese eshte e mundur qe perfitime ekonomike te ardhshme te trupezuara ne pjese do te qarkullojne ne Shoqeri dhe kostoja e saj mund te vleresohet besueshem. Vlera e mbartur e pjeseve te zevendesuara nuk njihen .

Kostoja e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihet ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve ku ndodhin .

(cii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve me baze lineare. Toka dhe punimet ne proces nuk amortizohen. Me poshte jane perafersime te jetes se dobishme:

<u>Baze vlera e mbetur</u>	31.12.2024 (ne%)	31.12.2023 (ne%)
• Ndertesa	5	5
• Instalime te pergjithshme	20	20
• Instalime teknike, makineri dhe pajisje	20	20
• Mjete transporti	20	20
• Pajisje zyre-furnitura	20	20
• Kompjutera dhe pajisje zyre-kompjutera	25	25

(d) Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet jo materiale, të cilat përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike, njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka. Amortizimi shpërndahet duke përdorur metodën lineare të amortizimit.Norma e amortizimit e përdorur për aktivet afatgjata jo materiale eshte 15%. Jeta e dobishme e vlerësuar dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese vjetore, duke njohur në periudhat pasuese efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël.

(e) Inventari

Inventari vleresohet me vleren me te ulet midis kosos dhe vleres se realizueshme . Kostoja e inventarit bazohet ne Koston mezatare te ponderuar, dhe perfshin shpenzime te ndodhura gjate blerjes se inventarit, kosto prodhimi ose kosto transformimi dhe kosto te tjera te lidhura me sjelljen e tyre ne kushtet dhe pozicionin ekzistues. (Ne rastin e inventarit te prodhuar dhe prodhimit ne proces, kosto perfshin nje pjese te caktuar shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit bazuar ne kapacitetin normal te aktivitetit nuk ka).

Vlera e realizueshme neto eshte cmimi i shitjes i vleresuar ne rrjedhen normale te biznesit, minus kostot e finalizimit dhe shpenzimet e shitjes.

(f) Perkeqesimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar vleresohet ne cdo date bilanci per te percaktuar nese egziston ndonje tregues per perkeqesimin e aktivit. Nje aktiv financiar konsiderohet per t'u perkeqesuar nese ka evidence objektive qe tregon se nje ose me shume ngjarje kane patur nje efekt negative ne flukset e ardheshme te vleresuara te aktivit.

Nje humbje nga perkeqsimi e lidhur me nje aktiv financiar te vleresuar me kosto te amortizuar, llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres se tashme te flukseve te ardhshme te parashikuara te skontuar me normen efektive te interesit . Nje humbje nga perkeqsimi i nje aktivi

financiar te mbajtur per shitje llogaritet duke iu referuar vleres se tij te drejte . Aktivet financiare qe jane individualisht te medhenj testohen per perkeqesim ne menyre individuale. Aktivet e mbetura financiare vleresohen se bashku ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te rrezikut te kredise. Te gjitha humbjet nga perkeqesimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo humbje e akumuluar e lidhur me ndonje aktiv financiar te mbajtur per shitje e njohur me pare ne kapital, transferohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Nje humbje nga perkeqesimi stornohet nese stornimi mund te lidhet ne menyre objektive me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga perkeqesimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar dhe aktivet financiare te mbajtura per shitje qe jane letra me vlere te borxhit, stornimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Per aktivet financiare te mbajtura per shitje qe jane letra me vlere te kapitalit , stornimi njihet drejtperdrejte ne kapital.

(ii) Aktivet jofinanciare

Vlerat kontabel te aktiveve jofinanciare te Shoqerise, pervec inventarit dhe aktiveve te tatimit te shtyre, rishikohen ne cdo date raportimi per te percaktuar nese egziston ndonje tregues per perkeqesim. Nese egziston ndonje tregues i tille, ateherë duhet vleresuar shuma e rikuperueshme e aktivitetit. Per emrin e mire dhe aktivet e paprekshme qe kane jete te papercaktuar ose qe nuk jane ende te gateshem per perdorim, shuma e rikuperueshme vleresohet ne cdo date raportimi.

Shuma e rikuperueshme e nje aktiviteti ose e nje njesie qe gjeneron para eshte me e madhja midis vleres se saj ne perdorim dhe vleres se saj te drejte minus koston e shites. Gjate vleresimit te vleres ne perdorim, flukset e ardhshme te pritshme te parase skontohej ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per aktivitetin. Per qellime te testimit te perkeqesimit aktiviteti grupohet se bashku ne grupin me te vogel te aktiveve qe gjeneron flukset hyrese te parase te aktiveve te tjera ose grupeve te tjera te aktiveve ("njesite qe gjenerojne para ").

Nje humbje nga perkeqesimi njihet nese vlere kontabel e nje aktiviteti ose njesie e tij qe gjeneron para tejkaloj shumen e tij te rikuperueshme te parashikuar. Humbjet nga perkeqesimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga perkeqesimi te njohura ne lidhje me njesite e gjenerimit te parase perdoren me pare per te pakesuar vleren kontabel te emrit te mire qe mund t'i jete ngarkuar njesive dhe me pas per te pakesuar vleren kontabel te aktiveve te tjera te njesise (grupi i njesive) ne menyre perpjessim. Humbjet nga perkeqesimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohen ne cdo date raportimi per ndonje tregues qe humbja eshte pakesuar ose nuk egziston me. Nje humbje nga perkeqesimi stornohet nese ka pasur ndryshim ne parashikimet e bera per te percaktuar shumen e rikuperueshme. Nje humbje nga perkeqesimi stornohet deri ne masen qe vlere kontabel e aktivitetit te mos tejkaloje vleren kontabel qe do te ishte percaktuar, minus zhvleresimin ose amortizimin, nese nuk do te ishte njohur humbje nga perkeqesimi .

(g) Perfitimet e punonjesve

(i) Kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontribute te detyrueshme te sigurimeve shoqerore qe u sigurojne perfitime pensione punonjesve pas daljes ne pension. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per sigurimin e kufirit minimal te caktuar me ligj per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani te percaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqerise ne planin e perfitimit te pensioneve ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ateherë kur ndodhin.

(ii) Leje vjetore e paguar

Shoqeria njej si detyrim shumen e paskontuar te kostove te parashikuara lidhur me lejen vjetore qe pritet te paguhet ne kembim te sherbimit te punonjesve per periudhen e perfunduar.

(h) Provizionet per rreziqe

Nje provision njihet ne qofte se, si rezultat i nje ngjarje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim aktual ligjor ose te terthorte qe mund te vleresohet ne menyre te besueshme, dhe eshte e mundur qe nje fluks dales perfitimesh ekonomike do te kerkohet per te shlyer detyrimin. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e ardhshme te pritshme te parase me nje norme para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per detyrimin .

(i) Ristrukturimi

Nje provision per ristrukturim njihet kur Shoqeria ka miratuar nje plan te detajuar dhe formal ristrukturimi , dhe ristrukturimi ka filluar ose eshte shpallur publikisht . Per kostot e ardhshme operative nuk llogaritet provision .

(ii) Restaurim i truallit

Ne perputhje me politiken e publikuar mjedisore te Shoqerise dhe me kerkesat ligjore ne fuqi, nje provision per restaurim truallit ne lidhje me tokat e ndotura, dhe shpenzimi perkates njihet kur toka eshte ndotur.

(iii) Kontratat "onerous"

Nje provision per kontratat e onerous njihet kur perfitimet e pritura te Shoqerise nga nje kontrate jane me te vogla se kostot e pashmangeshme per te permbushur detyrimet e saj sipas kontrates. Provizioni matet si vlere aktuale e me te vogles midis kostos se pritur ne rast prishjeje te kontrates dhe kostos neto te pritur ne rast vazhdimi te kontrates. Perpara krijimit te provizionit, Shoqeria njej cdo humbje nga perkeqesimi i aktiveve te lidhura me ate kontrate.

(i) Njohja e te ardhurave

(i) Mallrat e shitur

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

Te ardhurat nga shitja e mallrave jane matur me vleren e drejte te pagesave te arketuara ose te arketueshme , pakesuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat , taksat e rruges dhe te tjera te ngjashme). Te ardhurat njihen kur rreziqet dhe perfitimet nga pronesia jane transferuar te blerese, arketimi i pagesave eshte i mundshem, kostot e lidhura dhe kthimi i mundshem i mallrave mund te parashikohen ne menyre te besueshme, nuk ka pjesmarrje te metejshme ne menaxhimin e mallrave dhe shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme. Transferimet e rreziqeve dhe te perfitimeve ndryshojne ne varesi te kushteve specifike te kontrates se shitjes.

(ii) Sherbimet

Te ardhurat nga sherbimet e kryer jane njohur si fitim ose humbje ne perpjestim me fazen e perfundimit te transaksionit ne daten e raportimit. Faza e perfundimit vleresohet duke iu referuar inspektimeve te punes se kryer.

(iii) Ndryshime ne vleresime kontabel

Pergatitja e pasqyrave financiare individuale te veçanta ne perputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabel dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet kryesore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacioni mbi elementë të rëndësishëm të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabel që kanë një efekt shumë të rëndësishëm në shumën e njohur në

pasqyrat financiare të veçanta, përshkruhet në shënimet shpjeguese përkatëse të pasqyrave financiare të veçanta.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

Vlerësimi kontabël më i rëndësishëm për shoqërinë është ai që lidhet me recuperueshmërinë e llogarive të arkëtueshme dhe aplikimi i Standardit Nderkombëtar të Raportimit Financiar 16. Administratorët e shoqërisë klasifikojnë si indikacion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme momentin kur marrëdhëniet e biznesit me klientin janë ndërprerë dhe kanë filluar proceset gjyqësore që lidhen me klientin. Për qëllime të hartimit të pasqyrave financiare për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2024, administratorët e shoqërisë kanë konsideruar ditëvonesat në arkëtimin e shërbimeve si indikacion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme të shoqërisë. Lidhur me aplikimin e Standardit Nderkombëtar të Raportimit Financiar 16, Drejtimi ka konsideruar datën 1 tetor 2023, datë kur 70% e kuotave të kapitalit të shoqërisë u shiten tek ASSECO SEE.

(j) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen atëherë kur ndodhin.

(k) Pagesat e qerase

Pagesat minimale të qerave bëjnë për qerata financiare janë ndare ndërmjet shpenzimit financiar dhe paksimit të detyrimit ekzistues. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë përgjatë afatit të qerave në mënyrë që të paraqesë një normë të pandryshueshme të interesit mbi tepricën e mbetur të detyrimit. Pagesat e mundshme të qerave kontabilizohen duke shqyrtuar pagesat minimale të qerave përgjatë afatit të mbetur të qerave, pasi të konfirmohet korrigjimi i qerave.

(l) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe te ardhurat nga kembimi valutash që njihen si fitime ose humbje. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazë rrjedhese, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kembimi valutash.

(m) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin mbi fitimin ose humbjen për vitin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyre. Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve përveç pjesës që lidhet me zera të njohur drejtpërdrejt në kapital, rast në të cilin ai njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pagueshem i pritshëm mbi te ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e hartimit të bilancit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshem në lidhje me vitet e kaluara.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit, duke siguruar diferencat e perkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Shuma e llogaritur e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit ose shlyerjes së vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e përgatitjes së bilancit.

Nje aktiv i shtyre tatimor njihet vetem ne qofte se ekziston mundesia e realizimit te fitimeve te tatueshem perkundrejt te cileve aktiv i mund te perdoret. Aktivet tatimore te shtyre reduktohen ne momentin qe nuk eshte me e mundur qe perfitimet tatimore te lidhura me to te realizohen.

(n) Standarte te reja dhe interpretime qe kane filluar te zbatohen

Ne daten e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare, kishin dale interpretimet dhe amendimet e reja te meposhteme te standarteve me rendesi per veprimtarite e Shoqerise, qe kane hyre ne fuqi dhe jane zbatuar plotesisht gjate pergatitjes se ketyre pasqyrave financiare :

IFRS 7 Instrumentet financiare ; Shenime Sqaruese.

Standarti do te kerkoje me shume sqarime ne lidhje me instrumentet financiare te Shoqerise. Ai zevendeson SNK 30, Shenimet sqaruese ne Pasqyrat Financiare te Bankave dhe te Institucioneve Financiare te Ngjashme dhe eshte i zbatueshem nga te gjitha njesite qe pergatisin pasqyra financiare ne perputhje me SNRF. Shoqeria gjykon se sqarimet e rendesishme shtese qe kerkohen do te lidhen me objektivat, politikat dhe proceset e drejtimit te rrezikut te saj financiar.

IFRS 8 Segmentet Operative

Standarti kerkon shenime sqaruese mbi segmentin bazuar mbi perbersit e njesise qe menaxhimi monitoron gjate marrjes se vendimeve mbi ceshtjet operative. Segmentet operative jane perberes te nje njesie per te cilet eshte i disponueshem informacion financiar i vecante qe vleresohet rregullisht nga marresi kryesor i vendimeve operative kur vendos se si t'i shperndaje burimet dhe kur vlereson performancen. Shoqeria gjykon se kerkesat e standartit do te kene ndikim pjesisht te rendesishem mbi pasqyrat financiare .

IFRIC 7 Zbatimi i Perqasje se Korrigjimit sipas IAS 29 Raportimi Financiar ne Ekonomite Hiperinflacionare, kerkon zbatimin e IAS 29 kur nje ekonomi fillimisht shnderrohet ne hiperinflacionare dhe ne vecanti ne kontabilizimin e tatimit te shtyre . IFRIC 7, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2018, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 8 Qellimi i IFRS 2 Pagesat me ane te aksioneve adreson kontabilizimin e transaksioneve te pagesat me ane te aksioneve ku disa ose te gjitha mallrat apo sherbimet e marra nuk mund te identifikohen ne menyre specifike. IFRIC 8 i cili eshte bere i detyrueshem per paqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi paqyrat financiare .

IFRIC 9 Rivleresimi i Derivativeve te Fshehur kerkon qe nje rivleresim nese derivativet e nenkuptuar duhet te ndahen nga kontratat baze mikespritesa te behet vetem kur ka ndryshime ne kontrate. IFRIC 9, eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

IFRIC 10 Raportimi Financiar dhe Perkeqesimi i Ndermjetem ndalon kthimin mbrapsht te nje humbjeje nga perkeqesimi te njohur ne nje periudhe te meparshme te ndermjetme ne lidhje me emrin e mire, investimin ne nje instrument kapitali ose aktivin financiar te mbajtur me kosto. IFRIC 10, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare .

IFRIC 11 IFRS 2 Group dhe Transaksionet me Aksione Thesari kerkon qe nje marrveshje me pagesa me ane taksioneve ne te cilen nje entitet merr te mira dhe sherbime ne shkembim te instrumenave te kapitalit e cila duhet te njihet si nje transaksion me pagesa me ane te aksioneve , pavarsisht nese instrumentat e kapitalit jane marre. Po ashtu jep udhezime ne marrveshjet e transaksioneve me aksione, net e cilat furnizuesit e te mirave dhe sherbimeve te nje entiteti jane dhene me instrumenta kapitali te shoqerise meme te entitetit , dhe duhet te njihet si nje transaksion



me pagesa me ane te aksioneve, pavaresisht ne se instrumentat e kapitalit jane marre ne considerate ne pasqyrat financiare te entitetit. IFRIC 11, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 12 Rregullimi i Sherbimeve te Koncesionit udhezoi njesite e sektorit privat mbi ceshtje te caktuara te njohjes dhe matjes qe linden ne kontabilitet per rregullimet e sherbimeve te koncesionit nga sektori publik tek ai privat. IFRIC 12 i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk do te kete ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

Amendim i IAS 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare; Si nje amendim plotesues i lindur nga IFRS 7 (shiko me siper) , standarti do te kerkoje me shume shenime sqaruese ne lidhje me kapitalin e Shoqerise. Shoqeria nuk prëet qe ky amendim te kerkoje sqarime te rendesishme shtese persa i perket strukture se kapitalit te shoqerise.

IFRIC 14 IAS 19-Limitet e nje Aktivi Benefiti te percaktuar, Kerkesat dhe nderveprimi e Financimeve Minimale sqaron kur rimbursimet dhe reduktimet ne kontributet e ardhshme ne lidhje me aktivet e benefiteve te percaktuara duhet te trajtohen si te vlefshme dhe jep udhezime ne ndikimin e kerkesave te financimit minimal (MFR) te ketij aktivi. Po ashtu adreson kur nje MFR mund te krijoj nje detyrim. IFRIC 14, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

4. Administrimi i riskut financiar

Veshtrim i pergjithshem

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrisqeve te meposhteme per shkak te perdorimit te instrumentave financiare:

- Risku i kredise
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Ky shenim paraqet informacion mbi ekspozimin e shoqerise ndaj secilit risk te permendur me siper objektivat e Shoqerise, politikat dhe proceset per matjen dhe administrimin e riskut, dhe per administrimit te kapitalit te shoqerise. Shenime te tjera cilesore dhe sasore jane te perfshira ne pasqyrat financiare.

Drejtoria ka pergjegjesine per krijimin dhe kontrollin e sistemit te administrimit te riskut per Shoqerine. Drejtoria raporton rregullisht tek Keshilli mbikqyres mbi aktivitetin e tij.

Politikat per administrimin e riskut te Shoqerise jane vendosur per te identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqeria, per te percaktuar limitet dhe kontrollet e pershtateshme per cdo risk dhe per te monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve.

(i) Risku i kredise dhe perqendrimi

Risku i kredise eshte risku i humbjes financiare per Shoqerine ne qofte se nje kliente ose pala tjeter ne nje instrument financiar nuk i permbush detyrimet kontraktuale dhe rrjedh kryesisht prej arketimeve te Shoqerise nga klientet dhe letrat me vlere te investimit.

Investimet

Shoqeria ka investime financiare.

(ii) Risku i likuiditetit



Risku i likujditetit eshte rreziku qe Shoqeria nuk do te arrije te plotesoje detyrimet e saj financiare ne maturimin e tyre. Rruga qe ndjek Shoqeria per menaxhimin e likujditetit eshte te siguroje, per aq sa ka mundesi, qe do te kete gjithmon likujditet te mjaftushem per te permbushur detyrimet e saj ne maturim, ne kushte normale dhe te forcuar, pa krijuar humbje te papranueshme ose demtime riskore per reputacionin e Shoqerise.

(iii) Risku i tregut

Risku i tregut eshte rreziku qe ndryshimet ne cmimet e tregut, si kursi i kembimit dhe normat e interesit do te ndikojne ne te ardhurat e Shoqerise ose ne vleren e instrumentave te saj financiar. Objektivi i administrimit te riskut te tregut eshte te administroje dhe te kontrolloje ekspozimin ndaj riskut te tregut brenda parametrave te pranueshem, nderkohe qe pritet nje kthim optimist.

Risku i kursit te kembimit

Shoqeria nuk eshte e ekspozuar ne menyre domethenese ndaj riskut te kursit te kembimit. Transaksione te tjera te rendesishme kryen ne monedha te tjera si Euro ose USD . Kredite dhe huate regjistrohen ne monedhen me te cilen do te kete hyrje ne para nga operacioni ne fjale i Shoqerise.



HELIUS SYSTEMS Sh.p.k.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2024

5. Aktivet Afatgjata Materiale

Me 31 Dhjetor 2024 Aktivet Afatgjata Materiale paraqiten si me poshte:

	Truall	Instalime teknike, makineri, pajisje,	Mobilje pajisje zyre	Mjete transporti	Pajisje informatike	Te tjera	TOTAL
AAM Vlera Bruto							
Gjendje 01.01.2024			10,338,123	5,732,048	13,629,441	3,481,927	33,181,539
Shtesa					5,228,419	1,644,834	6,873,253
Pakesime				1,855,500			1,855,500.00
Riklasifikime nga CIP							
Tjeter							-
Gjendje 31.12.2024	-	0	10,338,123	3,876,548	18,857,860	5,126,761	38,199,292.27
ZHVLERESIM i AKUMULUAR							
Gjendje 01.01.2024			7,873,747	4,232,776	8,525,276	2,794,253	23,426,051.14
Shtesa			492,875	268,998	1,502,633	192,363	2,456,868.90
Pakesime				1,031,969			1,031,969.00
Riklasifikime nga CIP							-
Tjeter							-
Gjendje 31.12.2024	-	0	8,366,622	3,469,805	10,027,908	2,986,616	24,850,951
Vlera e mbetur neto							
Gjendje 01.01.2024	-	0	2,464,376	1,499,273	5,104,165	687,674	9,755,488
Gjendje 31.12.2024	-	0	1,971,501	406,744	8,829,952	2,140,145	13,348,341

6. AKTIVET AFATSHKURTRA

a. Kerkesa te arketueshme

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 Kerkesat e Arketueshme paraqiten si me poshte:

	31/12/2024	31/12/2023
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit	155,448,000	-
Bashkia Dimal	2,969,551	4,461,051
Posta Shqiptare sha	4,004,501	7,253,501
Gutenberg Technology	14,095,518	16,034,324
Dhoma Kombetare e Noterise (DHKN)	4,025,484	3,916,858
Keendoo Sas	4,058,306	3,885,735
Kliente te ndryshem	2,790,741	18,915,378
Kreditimi Rural I Kosoves		17,497,547
ILIRIA`98 INVEST	19,714,409	26,059,337
TOTALI	207,106,510	98,023,731
Zhvlersim i te drejtave (Klienteve)	(20,734,006)	
TOTALI NETO	186,372,504	98,023,731
Levizja e zhvleresimit te drejtave eshte si me poshte:		
Gjendje me 01 Janar		
Shtesa gjate vitit		
Pakesuar gjate vitit		
Gjendje ne fund te vitit	186,372,504	98,023,731

b. Kerkesa te tjera te arketueshme

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 Kerkesat e tjera te Arketueshme paraqiten si me poshte:

	31/12/2024	31/12/2023
Tatim mbi fitimin (teprica debitore)	4,593,356	1,253,881
Shteti -TVSH per t'u marre		
Debitore te tjere (Parapagime)	2,038,253	2,035,053
Te arketueshme te tjera		1,018,638
Tatime te shtyra	1,616,638	-
Shpenzime te periudhave te ardhshme	9,275,601	-
Subtotal	17,523,849	4,307,571
Zhvleresim i te tjera kerkesave		
Total	17,523,849	4,307,571

Debitore te tjere, parapagime	31/12/2024	31/12/2023
Parapagim, KOASH	1,095,653	1,095,653
Granci Bankare Cash Colateral 50.000 USD	942,600	939,400
Total	2,038,253	2,035,053

c. Aktive Monetare

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 gjendja e aktiveve monetare paraqitet si me poshte:
Cash dhe ekuivalente te tij,perfshire ne shenimin e mesiperm, te analizuara ne monedhat qe vijojne:

	31/12/2024	31/12/2023
Gjendje ne arke (Cash ne dore)	853,775.02	390,881
Gjendje ne Banka (Cash ne Banka)	46,299,495.50	86,999,012
Total	47,153,271	87,389,893

	31/12/2024	31/12/2023
Monedha lokale	7,030,436	5,420,743
EURO	29,621,975	63,076,950
USD	10,500,865	18,892,200
Total	47,153,276	87,389,893

	31/12/2024	31/12/2023
Eur	€ 301,803.11	€ 607,209.76
ALL 2024 : 98.15 ; 2023 : 103.88	29,621,975.2	63,076,950
USD	\$ 111,403.19	\$ 201,109.22
ALL 2024 : 94.26 ; 2023 : 93.94	10,500,864.69	18,892,200

Shoqeria ka llogari bankare ne 3 Banka.

Monedhat e perdoruar jane Leke, Euro dhe Dollar. Gjendja e arkave dhe bankave ne dt 31.12.2024 eshte vlersuar me kursin e fund vitit 1 euro = 98.15 leke dhe dollar 94.26 leke.

7. Kapitali

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 situata e kapitalit paraqitet si me poshte:

	31/12/2024	31/12/2023
Kapitali i autorizuar, i leshuar & Plotesisht i paguar.	1,000,000	1,000,000

<i>Emri i Aksionerit (Ortakut)</i>	<i>Numri i pergjithshem i kuotave</i>	<i>Perqindja e aksionit</i>	<i>Vlera e aksioneve</i>
Alkid Ademi	1.00	15.00%	150,000
Gjergji Mulla	1.00	15.00%	150,000
ASSECO SEE	1.00	70.00%	700,000
	3.00	100%	1,000,000



8. Rezerva ligjore

Shoqeria nuk ka rezerva ligjore me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023.

9. DETYRIMET AFATGJATA

a. Detyrimi per qirane financiare afatgjate

	31/12/2024	31/12/2023
Detyrimi per qirane financiare afatgjate	6,093,691	3,468,898
Total	6,093,691	3,468,898

b. Detyrim per grantet dhe te ardhurat e shtyra

Me 31.12.2024 shoqeria ka nje detyrim sipas kontrates se grantit me palen Helvetas Swiss Intercooperation Albania ne vleren 1,018,638 ALL:

	31/12/2024	31/12/2023
Grant Helvetas Swiss Intercooperation Albania	1,018,638	1,018,638
Total	1,018,638	1,018,638

10. DETYRIME AFATSHKURTRA

a. Furnitore

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 gjendja e furnitoreve paraqitet si me poshte:

Furnitoret 2024	31/12/2024
Mihal Bica	1,655,000
ASEE HPK	4,168,747
Chess Marketing	1,766,700
Web Best Solutions	1,766,700
Primus Advertisement shpk	2,159,300
WDM Agency Shpk	1,766,700
Furnitore te tjere	7,083,079
Total	20,366,225

Furnitoret 2023	31/12/2023
Tirana Panel Clinic	1,385,900
KOASH (Kisha Orthodhokse Autoqefale)	741,692
Kristian Sota	216,667
Marin Collaku	367,500
Alis Pustina	354,000
Ameljo Gjoni	352,000
Furnitore te tjere	3,194,715
Total	6,612,474

Shoqeria ka marredhenie me furnitore brenda dhe jashte vendit. Furnitoret e huaj ne valute jane vleresuar me kursin e fundit te vitit dhe diferencat jane sistemuar ne pasqyrat e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Furnitoret jane vleresuar me kursin zyrtar te fund vitit 1 euro=98.15 leke dhe 1 usd=94.26 leke.

b. Te tjera te pagueshme

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 gjendja e detyrimeve afatshkurtra paraqitet si me poshte :

	31/12/2024	31/12/2023
Paga dhe shperblime	31,337	3,756,408
Detyrime per sigurimet shoqerore	2,408,704	1,734,931
Shteti per tatim taksa*	27,569,565	6,249,378
Dividentë për t'u paguar	14,437,641	597,621
Depozite dyvjecare	552,381	550,000
Shpenzime te periudhave te ardhshme	43,368,953	
Tatime te shtyra	1,609,760	47
Kliente te mbipaguar	8,592	204
Total	89,986,934	12,888,589

Analiza e detajuar e detyrimeve ndaj shtetit paraqitet me poshte:

Analiza te shteti per tatim taksa	31/12/2024	31/12/2023
Tatim mbi te ardhurat personale	1,889,991	1,645,765
Tvsh	25,679,574	4,603,613
Tatim mbi fitimin		
Total Shtesa	27,569,565	6,249,378

12. Tatim Fitimi

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023, tatim fitimi paraqitet si me poshte:

	31/12/2024	31/12/2023
Tatim fitimi llogaritur	1,509,519	5,656,168
Tatim fitimi paguar gjate vitit	6,102,876	6,910,048
Plus / Minus		
Tatimi mbi fitimin ne Bilanc	4,593,356	1,253,881
Fitimi ushtrimit	25,329,248	110,092,465
Plus : Shpenzime te panjohura	4,861,135	3,030,885
Shpenzime te tjera		
Taksa & gjoba		
Total	30,190,384	113,123,350
Fitimi para tatimit	30,190,384	113,123,350
Minus : Te ardhura jo te taksueshme		
Humbje taksash te viteve te meparshem		
Total	30,190,384	113,123,350
Perfitime te taksueshem		
Norma e tatimit mbi fitimin	5%	5%
Tatime te shtyra 17/b		
Tatim fitimi per vitin	1,509,519	5,656,168
FITIMI NETO NE BILANC	23,819,729	104,436,298

Ne llogaritjen te tatim fitimit jane mare parasysh shpenzimet qe nuk jane te njohura per efekt fiskal sipas legjislacionit tatimor ne vleren 4,861,135 leke.

13. Shoqeri te lidhura (transkasionet midis degeve)

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve ose detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pa konsideruar nëse mbahen ndalesa. Një palë e lidhur është një palë e cila kontrollon, është e kontrolluar nga ose është nën të njëjtin kontroll me, njësinë; ka një interes në njësi e cila jep ndikim domethënës mbi njësinë; ose ka kontroll mbi njësinë, është një ortak i njësisë; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi është pjesëmarrëse; ose është pjesë e personelit kryesor të drejtimit të njësisë ose të shoqërisë mëmë (përfshirë anëtarët e ngushtë të familjes të secilit prej individëve të referuar më sipër).

Shoqeria nuk ka transaksione me palët e lidhura gjatë vitit 2024.



1. Te Ardhura dhe Shpenzime

Me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 te ardhurat dhe shpenzimet e Kompanise paraqiten si me poshte:

a. Shitjet

	<u>01/01/2024- 31/12/2024</u>	<u>01/01/2023- 31/12/2023</u>
Te ardhura nga ofrimi i sherbimit	286,290,662	315,532,078
Te ardhura nga shitje te tjera	2,206,000	-
Totali i: a) shitjeve	288,496,662	315,532,078

b. Shpenzime te tjera

	<u>01/01/2024- 31/12/2024</u>	<u>01/01/2023- 31/12/2023</u>
Qira per aktivitetin	112,981	125,000
Mirembajtje dhe riparime - Automjete	17,333	10,900
Shpenzim sigurime	26,615	53,954
Shpenzime konsulence - Financiare	2,087,740	971,808
Shpenzime konsulence - Juridike	1,238,400	743,362
Shpenzime kancelarie dhe te ngjashme	-	66,758
Shpenzime kafe, uje dhe te tjera per zyren	557,750	593,340
Shpenzime karburanti	-	6,000
Shpenzime te tjera per aktivitetin	23,545,571	4,324,760
Sherbime informatike	77,270,721	67,296,912
Energjie elektrike dhe uje	446,686	415,700
Provigjonime kliente	20,734,006	-
Shpenzime autofaturime	9,877,637	9,921,990
Dieta	107,861	1,489,954
Shpenzime telefoni celulare	90,000	60,323
Shpenzime Interneti	27,900	27,900
Komisione bankare	408,529	547,484
Taksa vendore+doganore	168,613	55,433
Gjoha	4,861,135	3,030,885
Total i: d) Shpenzime te tjera	141,579,478	89,742,464

c. Kosto e Punes

	<u>01/01/2024- 31/12/2024</u>	<u>01/01/2023- 31/12/2023</u>
Paga bruto dhe rroge (wages)	95,131,749	89,749,135
Kontribut sigurime shoqerore per punetoret	13,135,169	11,974,982
Total	108,266,918	101,724,117
Kosto stafi te tjera		
(Pension charge) Pagesa pensioni per vitin		
Total i: e) Kosto e Punes	108,266,918	101,724,117

*Numri mesatar i punonjesve me 31.12.2024 dhe 31.12.2023 eshte si me poshte.

	<u>01/01/2024- 31/12/2024</u>	<u>01/01/2023- 31/12/2023</u>
Punetore qe paguhen me ore pune		
Punetore rrogetare (mesatare)	66	64
Total	66	64

Shpenzimet jane paraqitur ne menyre analitike sipas natyres se tyre.

d. Amortizimet dhe zhvleresimet

	<u>01/01/2024- 31/12/2024</u>	<u>01/01/2023- 31/12/2023</u>
Amortizimi i aktiveve afatgjata	6,072,198	6,227,730
Provizione per zhvleresimin e aktiveve financiare		
Shpenzime te tjera (humbjet nga rivleresimi aktiveve)		
Total i: f) Amortizimet dhe zhvleresimet	6,072,198	6,227,730

e. Kembim monedhe (fitime)/humbje

	<u>01/01/2024- 31/12/2024</u>	<u>01/01/2023- 31/12/2023</u>
Kembim (fitime)/humbje qe rrjedhin gjate vitit	7,015,776	10,773,391
Kembim (fitime)/humbje qe rrjedhin nga vleresimi i fund-vitit te te ardhurave/pagesave	233,044	352,157
Total i: g) Kembim monedhe (fitime)/humbje	7,248,820	11,125,548



PËR MAKINAT												
Nr.	NIPT	Emri i Takimpaguesit	Lloji i mjetit	Tipi/Markë	Targë	Pronësia	Leje qarkullimi	Kapaciteti	Vlera kontabël	Vlera e mjetit e regjistruar	Viti i prodhimit	Bara siguruar e mjetit.
1	K91607030D	Helius Systems Sh.p.k	Autoveture	Honda CR-V RE6		Helius Systems Sh.p.k			2,077,390			
2	K91607030D	Helius Systems Sh.p.k	Autoveture	Wolkswagen		Helius Systems Sh.p.k			1,799,158			
3												
4												
5												
6												
7												
8												
9												
10												
11												
12												
13												
14												
15												
16												
17												

HELIUS SYSTEMS

MEMBER OF 

